| Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit) |  |

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontrates;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
    7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
  - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

|   |  |
|---|--|
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |
| <b>Vula</b>                               |  |
| <b>Datë</b> _____                         |  |

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| <i>1</i>                                  | <i>2</i>                       | <i>3</i> | <i>4</i>        | <i>6</i>                        |       |
|---|--------------------------------|----------|-----------------|---------------------------------|-------|
| Shërbimi                                  | Përshkrimi i shërbimi          | Sasia    | çmimi për njësi | Çmimi total për shërbim(3 x 4X) |       |
| 1.  |                                |          |                 |                                 |       |
| 2.  |                                |          |                 |                                 |       |
| 3.  |                                |          |                 |                                 |       |
| 4   |                                |          |                 |                                 |       |
|   | <b>Çmimi total (Shërbimet)</b> |          |                 |                                 | _____ |
| <b>Çmimi Neto pa TVSH</b>                 |                                |          |                 |                                 |       |
| <b>TVSH (%)</b>                           |                                |          |                 |                                 |       |
| <b>Çmimi total me TVSH:</b>               |                                |          |                 |                                 |       |
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |                                |          |                 |                                 |       |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |                                |          |                 |                                 |       |

---

|                   |  |
|-------------------|--|
| <b>Vula</b>       |  |
| <b>Datë</b> _____ |  |

**Shënim: Për plotësimin në mënyrë të saktë të shtojcës nr.2 (të ofertës ekonomike të detajuar) Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet ti referohen preventivave do të bashkëngjitura në DST e rreçdurës me objekt Mbikeqyrje punimesh me objekt: “Rikonstruksion i disa shërbimeve te S.U.O.GJ “Koço Gliozheni”, me REF-65274-04-06-2023të cituara si më poshtë.**



---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

**Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet ti referohen preventivave do të bashkëngjitura në DST e rpeçdurës me objekt Mbikeqyrje punimesh me objekt: “Rikonstruksion i disa shërbimeve të S.U.O.GJ “Koço Gliozheni”, me REF-65274-04-06-2023 të cituara si më poshtë.**

- Projekt HVAC godina e re
- Projekt HVAC godina ekzistuese
- Projekt i instalimeve elektrike godina e re
- Projekt i MKZ godina e ekzistuese
- Projekt konstruktiv formatuar
- Projekt arkitekture godina e propozuar
- Projekt arkitekture godina ekzistuese
- Projekt hidrosanitar godina e ekzistues
- Projekt hidrosanitar godina e propozuar
- Projekt i instalimeve elektrike godina ekzistuese
- Projekt i MKZ godina e propozuar
- Projekt konstruktiv shtesa anesore SPV.
- Preventivi pa çmime god.femra
- Preventivi pa çmime god.meshkuj
- Preventivi pa çmime permbledhesja
- Puntoria anliza
- Raport VNM Spitali Psikiatrik Vlore
- Relacion ark 2
- Relacion Teknik hidrosanitar object i propozuar
- Relacion Teknik hidrosanitar objekti ekzistues
- Relacion Teknik HVAC object i propozuar
- Relacion Teknik MKZ object ekzistues
- Relacion Teknik ark.1
- Relacion Teknik elektrik objekti ekzistues
- Relacion Teknik elektrik objekti i propozuar
- Relacion Teknik HVAC object ekzistues
- Relacion Teknik MKZ object i propozuar
- Grafiku I punimeve
- Harta e rilevimit A3

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

---

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimet që kërkohen që kërkohen:**

**Afatet e ekzekutimit:**

| <b>Shërbimet</b> | <b>Përshkrimi</b> | <b>Shuma</b> | <b>Vendi i ekzekutimit</b> | <b>Afati i ekzekutimit</b>    |
|------------------|-------------------|--------------|----------------------------|-------------------------------|
|                  |                   |              |                            | 6 muaj nga fillimi i punimeve |
|                  |                   |              |                            |                               |

---

## Shtojca 7

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **Mbikeqyrje punimesh me objekt: “Rikonstruksion i disa shërbimeve të S.U.O.GJ “Koço Gliozheni”**

#### Detyrat: 1.       **Objektivi kryesor i Mbikqyresit**

1.1 Mbikqyresi i punimeve të zbatimit të objektit ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjejë mbarevajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve dhe vlerën e kontratës.

#### 2.       **Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e Mbikqyresit**

2.1 Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të projektit, Mbikqyresi menjëherë mbas lidhjes së kontratës dhe fillimeve të punimeve duhet:

- Të mbikqyrë kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Autoritetit përgjegjës dhe të kryejë të gjitha detyrimet sipas kontratës së nënshkruar dhe legjislativës në fuqi. (sipas Ligjit Nr. 8402, dt. 10.09.1998, UKM Nr. 3, dt. 15.02.2011, UKM Nr. 1, dt.22.02.2005, UKM Nr. 2, dt. 13.05.2005).
  - Të njihet në detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësinë e punimeve.
  - Në bazë të volumit të punimeve dhe vlerës së kontratës Mbikqyresi i punimeve duhet të jetë rezident me kohë pune të plotë në objekt, ndërsa stafi tjetër mbikqyres mund të jetë rezident në objekt me kohë të pjesshme.
- 2.2 Mbikqyresi i punimeve dhe stafi i tij kontraktohet nga Autoriteti Përgjegjës, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin, etj.
- 2.3 Mbikqyresi ve në dijeni Autoritetin Përgjegjës për nenkontraktoret e mundshëm që zgjedh Sipermaresi (Zbatuesi i Punimeve) në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve.
- 2.4 Mbikqyresi në fillim të punimeve në objekt, merr kontakt me organet qeverisëse, në juridiksionin e të cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt, dhe informon personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti, në përputhje me legjislativën në fuqi (Neni 9, ligji Nr.8402, dt.10.09.1998).

#### 3.       **Detyrat e mbikqyresit**

3.1 Mbikqyresi ka për detyrë:

- Te beje verifikimin e te gjithë dokumentacionit perkates te licensave, te autorizimeve dhe te lejeve, te cilat sipas dispozitave ne fuqi duhet te merren para fillimit te punimeve.
  - Te beje verifikimin e sheshit te ndertimit, nese eshte i lire dhe gati per te filluar punimet.
  - Te njihet me hollesi me kontraten e zbatimit te punimeve dhe te gjithë akteve administrative qe lidhen me te, si dhe njohjen e te gjitha ndryshimeve te mundshme te kesaj kontrate me kalimin e kohes.
  - Te kontrolloje vendosjen e tabelës se identifikimit te objektit me te dhenat e meposhtme:
    - Emertimi i objektit:
    - Data e marrjes se lejes se ndertimit:
    - Investitori:
    - Projektuesi:
    - Sipermarresi dhe drejtuesi teknik:
    - Mbikqyresi:
    - Afati i ndertimit te objektit:
    - Vlera e objektit:
- 3.2 Mbikqyresi menjehere mbas lidhjes se kontrates duhet:
- Te marre masat e duhura per sigurine e objektit duke kontrolluar vendosjen ne objekt te tabelave perkatese sinjalizuese, treguese e te sigurise, shiritave, fenereve, etj.
  - Mbas verifikimit te dokumentacionit duhet te dorezoje prane Autoritetit Përgjegjës te gjithë dokumentacionin, si dhe shkresen per fillimin e punimeve ku te perfshihen:
    - Stafi i Sipermarresit
    - Makinerite qe do perdoren per ndertimin e objektit
    - Pikat e marrjes se lendeve te para inerte
    - Zonat e ngritjes se kantjerit
  - Para fillimit te punimeve verifikon te gjitha pajisjet dhe makinerite e Sipermaresit, per te pare nese ato i pergjigjen kushteve te kontrates se zbatimit.
  - Te kontrolloje zbatimin e projektit duke u bazuar ne projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe te propozoje modifikimet, plotesimet dhe mosperputhjet, nese ka, dhe ti propozoje Autoritetit Përgjegjës zgjidhjet konkrete.
  - Te ndjeke ne menyre te vazhdueshme e te kualifikuar te gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacione qe duhen te mbahen gjate zbatimit te punimeve, miratimin e analizave te veçanta, duke dhene udhezime, porosi e urdhera per zbatimin me perpikmeri e ne kohe te projektit, te kushteve teknike te projektimit dhe zbatimit te dispozitave perkatese te kontratave.
  - Te kontrolloje ne menyre korekte dhe te vazhdueshme piketimin e objektit dhe çdo material qe vendoset ne veper, menyren e vendosjes se tij dhe cilesine e tij.
  - Per çdo punim te maskuar te beje (fotografimin ose regjistrim e tij dhe te mbaje proces-verbal te firmosur prej tij dhe sipermaresit.
  - Ne çdo fund dite pune te kontrolloje ditarin e punimeve dhe te firmose ate.
  - Te kontrolloje librezen e masave, e cila verteton volumin e punimeve dhe ta miratoje ate.
  - Te kontrolloje çertifikatat e cilesise se materialeve dhe te jape miratimin per vendosjen e tyre ne objekt.
  - Gjate zbatimit te projektit, i jep udhezime me shkrim Sipermaresit, sa here qe e sheh te nevojshme dhe Sipermaresi eshte i detyruar t'i zbatoje ato. Ky i fundit, ka te drejte te beje me shkrim verejtjet e tij lidhur me udhezimet dhe urdherat e marra.
  - Per çdo rast, qe gjate zbatimit te punimeve lind nevoja e ndryshimeve ne projektin dhe preventivin e parashikuar, Mbikqyresi i punimeve duhet t'i paraqese Autoritetit

---

Përgjegjës nje relacion te plote teknik, shoqeruar me skicat perkatese ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi ne object, gjate zbatimit te punimeve, do te behet vetem pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor (Përgjegjës).

- Ne çdo fund muaji, Mbikqyesi ka per detyre te paraqese prane Autoritetit Përgjegjës raport mujor te punimeve. Ne kete raport duhet te jepet nje tablo e qarte e progresit te punimeve dhe te pagesave te kryera, realizimi i punimeve ne vlere dhe %, afati kohor, realizimi i financimit.
  - Korrespondenca ndermjet paleve behet gjithnje ne menyre zyrtare, me shkrim.
- 3.3 Raporti Mujor do te permbaje lenden e meposhtme:

- Hyrje
- Informacion i pergjithshem
- Te pergjithshme
- Qellimi i punimeve
- Mbikqyrja e punimeve ndertimore
- Personeli i siguruar nga Mbikqyesi
- Stafi i nevojshem ne perputhje me kontraten e zbatimit te punimeve
- Stafi aktual
- Koheqendrimi ne objekt per secilin pjesetar te stafit mbikqyres
- Raportimi
- Kohezgjatja e sherbimit te Mbikqyrjes
- Pershkrimi i Projektit
- Karakteristikat teknike dhe te dhena per objektin specifik
- Organizimi i Sipermaresit
- Sipermaresi
- Stafi prezent
- Mjete dhe makineri
- Koheqendrimi ne objekt
- Progresi Mujor
- Pershkrim te Punimeve qe jane kryer gjate muajit (sipas zerave dhe piketave)
- Fotografi te proçeseve te punimeve te kryera
- Fotografi te punimeve te maskuara per çdo punim te padukshem
- Grafiku i ecurise se punimeve
- Te aprovuara
- Te kryera
- Volumet Progressive te Punimeve Mujore
- Punimet e Aprovuara
- Çertifikatat e cilesise dhe Provat Laboratorike<sup>2</sup>,
- Libreza e Masave
- Punimet e Kryera por te pa aprovuara
- Situacionet mujore
- Matjet topografike
- Korrespondenca
- Proces-Verbale
- Urdhera, Udhezime, Njoftime
- Ndryshime ne Projekt - Preventiv nese ka (te aprovuara nga Autoriteti Përgjegjës)
- Moti (kalendarik)
- Problemet qe kane dale teknike, sociale

- 
- Konkluzione

#### **4. Përgjegjësi e Mbikqyresit**

4.1 Në fillim të punimeve Mbikqyresi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vendimin e sheshit e ndertimit dhe lejen origjinale zhvillimore.
- Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori së bashku me specifikimet teknike.
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologjiko-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet.
- Dokumentacionin për realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike.
- Saktësinë e vertetësinë e dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndertimit.
- Për realizimin me korrektesë të kontratës së nënshkruar midis Sipermaresit dhe Autoritetit Kontraktor, për realizimin e të gjithë fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit.
- Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e Mbikqyresit. Sipermaresi duhet të njoftojë Mbikqyresin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij.
- Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korespondencën me Autoritetin Kontraktor, urdherat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që i kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kerkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plote të të gjithë fazave të zbatimit të punimeve.
- Në rast se gjatë zbatimit të kontratës kemi ndërrim të Mbikqyresit, për dorëzimin e të gjithë dokumentacionit që disponon Mbikqyresi, i të gjithë dokumentacioni dorëzohet me proces-verbal ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërrimi.

#### **5. Të drejtat e Mbikqyresit**

5.1 Mbikqyresi ka të drejtë:

- Të kërkojë largimin nga puna të Drejtuesit të Kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paafësi ose pakujdesi të rende.
- Të mos pranojë drejtues teknik, manovrator, punëtor, etj, nëqë keta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.
- Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun.
- Të kërkojë çertifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materialeve.
- Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të Sipermaresit.
- Të mos lejojë vendosjen në veper të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe të zëvendësojë ato me materiale të tjera nga Sipermarresi me shpenzimet e tij.
- Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në veper dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurt dhe cilësore.



- Te mos lejoje perdorimin e makinerive dhe pajisjeve te ndryshme nqs ato jane jashte kushteve teknike.
- Ne rast se materialet dhe pajisjet e perdorura nuk miratohen nga Mbikqyresi keto duhet te dokumentohen me proces-verbalet e analizave te provave, se bashku me aktin teknik, ku te argumentohen shmangiet e palejuara referuar standardeve te percaktuara ne specifikimet teknike te projekt-zbatimit.
- Te kerkoje kryerjen e provave shtese per materialet e vendosura ne objekt, kur keto nuk jane kryer ne masen sipas vellimeve te realizuara dhe pjese se lendes se pare te furnizuar per te verifikuar cilesine. Shpenzimet per keto prova jane ne ngarkim te Sipermaresit.
- Kur Mbikqyresi i punimeve mendon se ka demtime ne konstrukcion, kerkon te behen verifikimet perkatese. Kur verifikimet i japin te drejte Mbikqyresit, shpenzimet jane ne ngarkim te Sipermaresit. Ne rast te kundert, Sipermaresi ka te drejte te kerkoje shlyerjen e shpenzimeve.
- Mbikqyresi i punimeve urdheron Sipermaresin te prishe dhe te ribeje me shpenzimet e tij, punime te bera jo me cilesine e parashikuar ne projekt dhe specifikimet teknike.
- Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te pezulloje perkohesisht punimet, per ekzekutim teknik te gabuar ose paaftesi teknike zbatimi, per çdo rast, me miratimin e Autoritetit Përgjegjës per aq kohe sa ai e konsideron te arsyeshme. Ne kete rast, sipas fajit, Mbikqyresi se bashku me Autoritetit Përgjegjës dhe Sipermaresin percaktojne zgjatjen ose jo te afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.
- Te kontrolloje dhe autorizojte perdorimin e fondit rezerve te preventivuar dhe i raporton periodikisht Autoritetit Përgjegjës per gjendjen e tij. Ne rast se Autoriteti Përgjegjës ka verejtje e njofton Sipermaresin dhe problemi zgjidhet midis tyre.
- Per çdo ndryshim te mundshem ne objekt, Mbikqyresi i punimeve ve ne dijeni Autoritetin Përgjegjës.

## 5.2 Ne perfundim te punimeve Mbikqyresi:

- Merr me shkrim njoftimin per perfundimin e punimeve dhe verteton ne proces-verbal daten e perfundimit te tyre sipas projektit, te ndryshimeve te urdheruara e te kushteve te kontrates dhe brenda 30 diteve merr prej Përgjegjës it dokumentacionin perkates.
- Sipas legjislacionit ne fuqi dorezon prane Autoritetit Përgjegjës te gjithë dokumentacionin perkates per te cilin mban pergjegjesi te plote ne plotesimin, saktesine dhe vertetesine e tij.

## 5.3 Ky dokumentacion duhet te permbaje:

- Proçes-verbalin e dorezimit te sheshit te ndertimit
- Proçes-verbalin per fillimin e punimeve
- Kontraten e Siper marrjes
- Kontraten e Mbikqyrjes
- Projekt organizimin e punimeve
- Projektin teknik te zbatimit
- Projektin e ndryshuar (nese ka) shoqeruar me korrespondencen, skicat perkatese dhe miratimet e nevojshme
- Preventivin fitues
- Preventivin e ndryshuar (nese ka zerat te rinj te punimeve, negocimin e tyre)
- Grafikon e punimeve
- Specifikimet teknike
- Azhornimin para fillimit te punimeve dhe piketimi
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinjeric per punime te paparashikuara
- Dokumentacionin fotografik apo video regjistruesi per punimet e padukshme

- Proçes-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe Mbikqyresi të shoqeruar me fotografi
  - Ditarin e objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdheruara nga Mbikqyresi
  - Librezen e masave
  - Shkresen e Mbikqyresit për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezerve, shoqeruar me dokumentacionin përkatës
  - Proçes-verbalin e përdorimit të fondit rezerve të firmosur nga Sipermarresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
  - Preventivin e fondit rezerve të firmosur nga Sipermarresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
  - Situacionin e fondit rezerve të firmosur nga Sipermarresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
  - Çertifikatat e cilësive të materialeve
  - Miratimin e materialeve të përdorura nga Mbikqyresi
  - Situacionet pjesore dhe situacioni përfundimtar
  - Regjistrin e kontabilitetit
  - Deklaratën teknike të Sipermarresit të firmosur nga Sipermarresi dhe drejtuesi teknik
  - Njoftimin e sipermarresit për përfundimin e punimeve
  - Proçes-verbalin e përfundimit të punimeve të firmosur nga Sipermarresi dhe Mbikqyresi, së bashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar
  - Relacionin përfundimtar të Mbikqyresit
- 5.4 I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e Mbikqyresit. Ky dokumentacion përgatitet e dorëzohet në 3 (tre) kopje.
- 5.5 Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë grupit të kolaudimit që ngrihet brenda 30 ditëve nga përfundimi i objektit. Të gjithë dokumentat që dorëzohen pranë grupit të kolaudimit duhet të jenë origjinale.
- 5.6 Mbikqyresi i punimeve merr pjesë në Kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet grupit të kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe firmos. Pas përfundimit të kolaudimit, Mbikqyresi i punimeve mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i behet e ditur Sipermarresit dhe i jepet për të likuiduar Autoritetin Përgjegjës.

## **6. Kohezgjatja e shërbimit të Mbikqyrjes**

- 6.1 Shërbimi i mbikqyrjes zgjat për të gjithë periudhën e zbatimit të punimeve.
- 6.2 Autoriteti Përgjegjës ka të drejtë të kërkojë largimin e Mbikqyresit kur verteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:
- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara
  - Nderprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre
  - Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuar, tolerim të materialeve jashtë cilësive të kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike
  - Kur vërehen shkelje të rëndësishme të dispozitave ligjore, Autoriteti Përgjegjës ka të drejtë të urdherojë Mbikqyresin e punimeve për nderprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjendjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbejnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione në bazë të legjislacionit në fuqi.

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

---

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Në rast se grupe operatorësh ekonomik mund të dorezojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat I vetëm për qëllimin e dorëzimit të ofertës në pjesëmarrje. Vetëm në rastet pasi të jenë shpallur fitues dhe vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës duhet të paraqesin forma ligjore specifike si më poshtë:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

### **Shënim:**

Referuar pikës 1, të **nenit 26**, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 **”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar** ,, ku parashikohet :

*“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”,*

si dhe përcaktimeve të **pikës 6**, të këtij neni:

*“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor (S.U.O.GJ “Koço Gliozheni) i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.**

---

**Në rast se operatorët ekonomikë të kualifikuar janë bashkim operatorësh ekonomikë secili prej operatorëve ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm si dhe:**

- a. Marrëveshja e **noterizuar**, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme e **noterizuar**.
- c. vërtetimet e pasqyruara apo dokumentacionin mbi vetëdeklarimet e kërkuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit.

Vetëm në rastet pasi të jenë shpallur fitues dhe vleresohet e nevojshme për realizimin kontratës duhet te paraqesin forma ligjore specifike.

Shënim: Në akt marrëveshje të përcaktohen qartë ndarja në %-je të punimeve që do të realizojë secila nga shoqëritë, për tërësinë e kategorive të punimeve që përmban preventivi, ose për kategori punimesh të veçanta, gjithnjë në raport me %-en e deklaruar.

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

**Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):  
Sipas Shtojcës 8.**

**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

a ) Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet).

b) Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë 40% të vlerës **se fondit limit** konkretisht: **437 096.95 (katerqind e tridhjetë e shtate mije e nentëdhjetë e gjashtë pike nentëdhjetë e pese)** lekë pa TVSH. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor

c) Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave

---

vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB). (Kjo kerkese do të konsiderohet e permbushur gjate fazes së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit).

### **Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës **se fondit limit** konkretisht, në vlerën **437 096.95 (katerqind e tridhjetë e shtate mijë e nentëdhjetë e gjashtë pike nentëdhjetë e pese)** lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tri viteve të fundit, nga data e njoftimit të kontratës së shpallur.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formularin/vërtetimin e vlerësimit për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes, ku të shenohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat si dhe shërbimi i mbikqyrjes së realizuar.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçensë profesionale** për “**Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi**”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi:

### **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:**

- **NP-3** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industrial, veshje fasadash.

### **Për punimet speciale të ndërtimit:**

- **NS-1** Punime për prishjen e ndërtimeve;
- **NS-2** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- **NS-4** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese;
- **NS- 8** Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri;
- **N.S – 12** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
- **NS-14** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.
- **NS- 19 A** Sistemet kundër zhurmës për infrastrukture

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

*Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit,*

---

*pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk koresponдон me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës.*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

Për të gjitha këto zera të punimeve operatori ekonomik që do të realizojë shërbimin e mbikqyrjes duhet të zotërojë licensën profesionale me pikat e sipërpermendura.

**4.** Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikqyrjes, të përfshirë në liçensën e shoqërisë ose të pajisur me liçensë individuale. Për stafin inxhinierik duhet të paraqiten kontratë pune (e vlefshme), diplomë përkatëse, licensë individuale profesionale si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

|                         |         |
|-------------------------|---------|
| - Inxhinier Ndërtimi    | 1 (një) |
| - Arkitekt              | 1 (një) |
| - Inxhinier Elektrik    | 1 (një) |
| - Inxhinier Mekanik     | 1 (një) |
| - Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |

Kjo kerkese do të konsiderohet e permbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit).

Shënim: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin

**5.** Një punësim mesatar i të paktën **10 (dhjete)** personave, për periudhën të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a.** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.
- b.** Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.

---

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 10 punonjësish, është percaktuar duke marrë në konsideratë fondin limit; natyrën e objektit të prokurimit i cili konsiston në ofrimin e shërbimit të mbikqyrjes si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm. Kjo kërkesë i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Ndërsa kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit plotësues lidhur me list-pagesat, dhe vërtetimin e pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, do të shërbejë Autoritetit Kontraktor së pari për vlerësimin e kapacitetit teknik të ofertuesit dhe gjithashtu duke qenë se procedura zhvillohet me mjete elektronike dhe dokumentet listëpagesë dhe vërtetim i numrit të punonjësve, lëshohen elektronikisht nëpërmjet portalit e-albania. Të gjitha kërkesat e përcaktuara në pikën 5 germa a) dhe b) janë në harmoni me njëra tjetrën dhe i shërbejnë qëllimit që kontrata objekt prokurimi të realizohet me sukses.

**6. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:**

- 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").*  
(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit).
  
- 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

